


Tiranë, më 10 prill 2019

KËRKESË



Drejtuar: Këshillit për Emërimet në Drejtësi

Për dijeni: Kuvendit të Shqipërisë

Objekti: Tërheqje e shprehjes së interesit për “vakancën e parakohshme” për 1 anëtar të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 24.12.2018

Baza ligjore: Pika 8 e Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërimet në Drejtësi

Të nderuar anëtarë të Këshillit,

Unë, e nënshkruara Marsida Xhaferllari, në datën 23.01.2019 kam paraqitur shprehjen e interesit për “vakancën e parakohshme” për 1 anëtar të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 24.12.2018. Tashmë, koha e mandatit plotësues pothuajse ka përfunduar, pa u kryer asnjë veprim. Ndërkohë, Kuvendi, për të njëjtin pozicion, ka shpallur thirrje për aplikim për mandat të plotë. Rrjedhimisht, organi i emërtesës - Kuvendi, në mënyrë të nënkuptuar, ka humbur interesin për thirrjen, në të cilën unë kam kandiduar. Në këto kushte dhe në bazë të pikës 8 të vendimit nr. 8/2019 të KED-së, nuk më mbetet veçse t’ju njoftoj edhe formalisht tërheqjen e kërkesës time nga kandidimi për këtë vakancë të përkohshme.

Duke ju uruar punë të mbarë,

Marsida Xhaferllari